REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-10158/26 datë: 20.05.2026

Npi – 01/106 datë: 29.05.2026

Duke u bazuar në nenin 12 shkronja (d) dhe 68.3 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Nr.03-L-048; Nenit 8 të Rregullores Komunale për Transparencë 01Nr.06/361/4, datë: 04.03.2009; Rregulloren e Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023. Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më: 29.05.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR DISKUTIM PUBLIK
TË DRAFT KORNIZËS AFATMESME BUXHETORE TË KOMUNËS SË SHTIMES
PËR PERIUDHËN 2027-2029

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IV- të rregullt për vitin 2026, të mbajtur më 29.05.2026, unanimisht miratoi Vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Shtimes për periudhën 2027-2029. Bartës të organizimit të aktiviteteve për procesin e diskutimt publik është Komiteti për Politikë dhe Financa, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, si dhe Zyra për Informim.

II

Vendimi është aprovuar duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SHTIMES-OPŠTINA ŠTIMLJE
V.V.
SHTIME-ŠTIMLJE

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahman Jakupi